

VENDIM
Nr. 822, datë 7.10.2015

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE TË NDËRTIMIT TË KAPACITETEVE TË REJA PRODHUESE TË ENERGJISË ELEKTRIKE, QË NUK JANË OBJEKT KONCESIONI

(ndryshuar me VKM nr. 718, datë 12.10.2016; nr. 633, datë 27.10.2021; nr. 192, datë 5.4.2023; nr. 117, datë 6.3.2024)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
 2. Vendimi nr. 1701, datë 17.12.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për procedurat e dhënies së autorizimeve për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese të energjisë, që nuk janë objekt koncesioni”, të ndryshuar, shfuqizohet.
 3. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

RREGULLAT DHE PROCEDURAT
E NDËRTIMIT TË KAPACITETEVE TË REJA PRODHUESE TË ENERGJISË
ELEKTRIKE, QË NUK JANË OBJEKT KONCESIONI

KAPITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

1. Qëllimi i këtyre rregullave është të përcaktojnë procedurat dhe dokumentacionin e nevojshëm për kërkesën, vlerësimin dhe dhënien e së drejtës për ndërtimin e një burimi të ri gjenerues të energjisë elektrike, që nuk është objekt koncesioni.
2. Këto rregulla janë hartuar në përputhje me pikën 2, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

Neni 2
Objekti

(shfuqizuar pika 2 me VKM nr. 718, datë 12.10.2016)

1. Objekt i këtyre rregullave dhe procedurave janë burimet e reja gjeneruese të energjisë elektrike, ndërtimi i të cilave bëhet me financime private, dhe që lidhen me rrjetet e transmetimit dhe/ose të shpërndarjes.
2. Shfuqizuar.

Neni 3

Përkufizime

(ndryshuar togfjalësh në përkufizimin "vetëprodhues" me VKM nr. 117, datë 6.3.2024)

Termat e përdorur në këto rregulla kanë kuptimin, si më poshtë vijon:

“Kërkesë”, çdo kërkesë e paraqitur nga një person, për ndërtimin e një burimi të ri gjenerues të energjisë elektrike, sipas formës së përcaktuar në këto rregulla;

“Kërkues”, çdo person që aplikon për një leje, sipas këtyre rregullave;

“Person”, një person fizik ose juridik;

“Vetëprodhues”, një person që prodhon energji elektrike, i cili konsumon, kryesisht, për nevojat e veta, një pjesë të energjisë së prodhuar dhe i cili nuk përfiton nga skemat e mbështetjes sipas parashikimeve të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme;

“Burim koogjenerues”, një burim gjenerues që prodhon nxehësi dhe energji elektrike;

“Pika e lidhjes”, pika fizike e lidhjes, e përcaktuar nga Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) ose “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” (OSSH), në të cilën burimi gjenerues do të lidhet me rrjetin e transmetimit ose të shpërndarjes;

“OST”, Operatori i Sistemit të Transmetimit;

“OSSH”, “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes”;

“Ministria”, ministria përgjegjëse për energjinë;

“Ministri”, ministri përgjegjës për energjinë;

“Studim parafisibiliteti”, një vlerësim paraprak, i përafërt, teknik, ekonomik, financiar dhe mjedisor i një projekti për ndërtimin e një kapaciteti të ri gjenerues të energjisë;

“Studim fisibiliteti”, një vlerësim i plotë teknik, ekonomik, financiar dhe mjedisor i një projekti për ndërtimin e një kapaciteti të ri gjenerues të energjisë;

“E drejta për të ndërtuar”, akti administrativ, i cili i jep mbajtësit të saj të drejtën për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”. Ky akt miratohet nga Ministri, për objektet deri në 2 mw, ndërsa mbi 2 mw, nga Këshilli i Ministrave.

“Miratim paraprak”, miratimi i ndërmjetëm, i dhënë nga Ministri, për vazhdimin e procedurave për marrjen e të drejtës për të ndërtuar;

“Mbajtësi i miratimit”, personi që merr një të drejtë për ndërtimin e burimit të ri gjenerues të energjisë elektrike, sipas dispozitave të këtyre rregullave.

KAPITULLI II

NDËRTIMI I BURIMEVE TË REJA GJENERUESE MBI 2 MW

Neni 4

E drejta për të aplikuar

1. Çdo person që zhvillon veprimtari tregtare, sipas legjislacionit shqiptar, mund të aplikojë për marrjen e një miratimi për ndërtimin e burimeve të reja gjeneruese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni, mbi 2 mw.

2. Çdo person i huaj, që kërkon të aplikojë për marrjen e një miratimi për ndërtim objekti gjenerues, sipas këtyre rregullave, duhet të krijojë një filial ose zyrë përfaqësimi në Shqipëri, sipas dispozitave të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, dhe kërkesave të legjislacionit tatimor shqiptar.

3. Çdo kërkesë, sipas këtyre rregullave, bëhet në Ministri.

Neni 5

Delegimi i autoritetit të kërkuës

1. Një kërkuës mund të caktojë një person fizik ose juridik, si të deleguar përgjegjës, për të aplikuar për ndërtimin e burimeve të reja gjeneruese të energjisë elektrike, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe procedurat e këtyre rregullave.

2. I deleguari pajiset me prokurën e kërkuës për përfaqësimin e tij në veprimet që kanë të bëjnë me kërkesën dhe marrjen e miratimit për ndërtim objekti gjenerues.

Neni 6

Forma e kërkesës

(ndryshuar pika 2 me VKM nr. 718, datë 12.10.2016; shtuar numër neni në pikën 1 me VKM nr. 117, datë 6.3.2024)

1. Çdo kërkesë për ndërtim objekti gjenerues bëhet vetëm në formën e përcaktuar në aneksin 1, të këtyre rregullave, dhe shoqërohet me dokumentet e parashikuara në nenet 7, 7/1, 8, 9 e 10, të këtyre rregullave.

2. Në momentin e dorëzimit të kërkesës, çdo kërkuës paraqet faturën e kryerjes së pagesës për atë kërkesë, në vlerën dhe numrin e llogarisë së ministrisë, siç përcaktohet në aneksin 2, të këtyre rregullave. Kërkesa dhe dokumentacioni bashkëlidhur tij quhet i dorëzuar prej kërkuës vetëm pas kryerjes së kësaj pagese.

3. Dokumentacioni i paraqitur nga kërkuësi duhet të jetë në gjuhën shqipe, origjinal ose fotokopje e noterizuar, dhe vërtetimet e deklaratat, nga organe të tjera, duhet të jenë lëshuar jo më parë se 3 muaj nga momenti i paraqitjes së kërkesës.

4. Çdo kërkesë, përveç dokumentacionit origjinal apo kopje të noterizuar, paraqitet edhe në formë elektronike (CD).

Neni 7

Dokumentacioni shoqëruar që kërkohet për një miratim

(ndryshuar me VKM nr. 718, datë 12.10.2016, shfuqizuar shkronja "ë" dhe ndryshuar shkronja "g" me vendimin nr. 633, datë 27.10.2021; shtuar shkronja "h" me VKM nr. 192, datë 5.4.2023)

Çdo kërkesë për një miratim ndërtimi shoqërohet me dokumentet dhe/ose informacionin, si më poshtë vijon:

a) Ekstrakt të Regjistrit Tregtar për të Dhënat e Subjektit, ekstrakt për historikun e subjektit, të lëshuara nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, me të cilat vërtetohen, ndër të tjera, se objekti i veprimtarisë së subjektit është në fushën energjetike, kërkuësi nuk është në proces falimentimi, nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, që lidhet me aktivitetin e tij profesional, statusi aktiv etj.;

b) Vërtetime për shlyerjen e detyrimeve tatimore, për pagesën e sigurimeve shoqërore, të shoqëruara me listëpagesat e sigurimeve, në të cilat të jenë përfshirë emrat e punonjësve, për secilin muaj (të vitit të fundit);

c) Dokument që vërteton se kapitalet/asetet e subjektit nuk janë në proces ekzekutimi nga përmbaruesi gjyqësor apo ekziston një urdhër sekuestroje për to, lëshuar nga zyra e përmbarimit në qytetin ku ndodhet selia e subjektit;

ç) Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë, të cilat duhet të jenë në emër të subjektit kërkuës, për çdo ambient ku subjekti kërkuës, ushtron aktivitetin e tij;

Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë, apo mungesa e lidhjes së kontratës për furnizim me energji elektrike të kërkuës me

furnizuesin publik për çdo ambient ku subjekti ushtron aktivitetin e tij, përbën shkak për refuzimin e kërkesës;

- d) Struktura organizative e shoqërisë;
- dh) Përshkrim të kapaciteteve teknike, organizative dhe profesionale të shoqërisë;
- e) Mjetet, pajisjet teknike në dispozicion apo që mund të vihen në dispozicion të kërkuarit;
- ë) Shfuqizuar;
- f) Numrin e identifikimit personal të zyrës së taksave (NUIS);

g) Për kërkesën e projekteve deri në 20 mw, kërkuari duhet të paraqesë një ose më shumë dokumente bankare në emër të subjektit kërkuar që, të marra së bashku, vërtetojnë se subjekti disponon 20% të vlerës së investimit të përgjithshëm të propozuar. Data e lëshimit të tyre (dokumente bankare) duhet të jetë jo më parë se 5 ditë nga dorëzimi i kërkesës. Për kërkesën e projekteve mbi 20 mw subjekti kërkuar paraqet dëshmi financiare të besueshme për mbulimin e financimit të projektit, të tilla si: dokumente bankare, bilance të shoqërisë, premtime financimi, garanci për mbështetje financiare nga shoqëria mëmë apo ortakët e shoqërisë, sigurim të kërkesës së lëshuar nga një agjenci sigurimi, në masën 2% të vlerës së investimit etj.

gj) Pasqyrat financiare, të audituara nga auditues të licencuar, të tri viteve të fundit të veprimtarisë dhe të certifikuara nga organet tatimore ose kur shoqëria ka më pak se tre vjet që është krijuar, për periudhën e ekzistencës së saj, si dhe çdo dokument tjetër financiar që provon aftësitë financiare për të realizuar projektin e propozuar.

h) dokumentacionin ligjor, në përputhje me dispozitat e Kodit Civil, që provon marrëdhënien afatgjatë mbi pasurinë që do të përdoret për ndërtimin e burimit gjenerues. Kërkesa refuzohet në rastet kur pasuria ku propozohet ndërtimi ka kufizime shfrytëzimi, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e tokës bujqësore dhe zonave të mbrojtura.

Neni 7/1

Kërkesa për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike eolike

(shtuar neni me VKM nr. 117, datë 6.3.2024)

1. Për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike eolike, subjekti i interesuar shpreh interesin për ndërtimin e një impianti eolik, duke paraqitur dokumentacionin, si vijon:

a) Dokumentacionin ligjor, në përputhje me dispozitat e Kodit Civil, që provon marrëdhënien afatgjatë mbi pasurinë që do të përdoret për ndërtimin e burimit gjenerues. Kërkesa refuzohet në rastet kur pasuria ku propozohet ndërtimi ka kufizime shfrytëzimi, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e tokës bujqësore dhe zonave të mbrojtura.

b) Një studim parafisibiliteti, i hartuar nga persona juridikë ose fizikë për ushtrimin e veprimtarisë profesionale të studimit dhe/ose projektimit, të impianteve nga burimet e rinovueshme të energjisë, të projektit të propozuar, si dhe ndikimin e tij mjedisor e social, i cili duhet të shoqërohet me paraqitjen e përgjithshme skematike të burimit gjenerues të energjisë, një diagram elektrik të aggregateve dhe bllokut të transformimit, ku të evidentohen qartë pika e lidhjes me sistemin dhe pika e matjes, shtrirja gjeografike e vendit ku do të ngrihet apo zhvillohet veprimtaria, duke dhënë referencat ekzakte (numër parcele, numër regjistri kadastrë dhe koordinatat në sistemin koordinativ gjeohapsinor KRGJSH) dhe të paraqitura në hartë, me shkallë 1:25'000 dhe një hartë topografike, ku të paraqitet gjurma e linjës që lidh burimin gjenerues me sistemin e transmetimit ose shpërndarjes, në shkallë 1:25'000.

2. Nëse ministria konstaton se shprehja e interesit plotëson kriteret teknike, ligjore, marrëdhënien me pasurinë që do të përdoret për ndërtimin e burimit gjenerues, i jep kërkuarit të drejtën prioritare për aplikimin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese dhe kryerjen e matjeve reale për një periudhë jo më pak se 12-mujore në zonën e propozuar për zhvillimin e projektit. Kur kërkesa pranohet, ministria publikon tri ditë me radhë, në faqen e *website*-it të ministrisë, një njoftim me të dhëna përshkuese për projektin e propozuar.

3. Subjektet pas marrjes së këtij miratimi brenda një afati 6-mujor duhet të raportojnë lidhur me instalimin e pajisjeve dhe fillimin e matjeve.

4. Në përfundim të këtij afati dhe bazuar në matjet reale të potencialit të erës në zonën e propozuar, kërkuesi paraqet dokumentacionin sipas parashikimeve të nenit 6, për vijimin e procedurave të mëtejshme për t'u pajisur me miratim paraprak për vazhdimin e procedurave për ndërtimin e kapacitetit të ri prodhues të energjisë elektrike eolike, sipas përcaktimit në këtë rregullore.

5. Subjektet kërkuese, të cilat zotërojnë të dhëna të mbledhura të erës, për zonën e tyre të interesit, mund të vijnë drejtpërdrejtë aplikimin për miratim, sipas parashikimeve të këtyre rregullave.

Neni 8

Të dhënat, informacioni i përgjithshëm për burimet gjenerues të energjisë dhe kriteret që duhet të plotësojë ndërtimi i tyre

1. Një kërkues paraqet në ministri, përveç dokumenteve dhe informacionit të përcaktuar në nenin 7, të këtyre rregullave, të dhënat dhe informacionin e përgjithshëm, si më poshtë vijon:

- tipin e burimit gjenerues të energjisë;
- kapacitetin e instaluar në mw;
- numrin e njësisë gjeneruese të burimit gjenerues të energjisë dhe kapacitetin e tyre në mw;
- prodhimin vjetor të energjisë elektrike, në mwh;
- afatin e pritshëm të vënies në punë;
- jetëgjatësinë e pritshme të burimit gjenerues të energjisë;
- numrin e orëve të punës, në vit;
- rendimentin e burimit gjenerues të energjisë;
- standardet teknike të pajisjeve të burimit gjenerues të energjisë;
- nivelin e tensionit në dalje të gjeneratorit;
- skemën kryesore elektrike të burimit gjenerues të energjisë dhe lidhjen e tij me rrjetin e transmetimit ose shpërndarjes;
- vlerën e parashikuar të investimit total;
- vendndodhjen e burimit gjenerues të energjisë dhe përshkrimin e infrastrukturës që mendohet të ndërtohet;
- strukturën e propozuar të kapitalit dhe burimet e parashikuara të financimit të ndërtimit të burimit gjenerues të energjisë;
- programin e zbatimit të projektit;
- përshtatshmërinë e pajisjeve të burimit gjenerues të energjisë me sistemin elektro-energjetik;
- përlogaritjen e emetimeve të gazeve të efektit serë nga burimet gjeneruese dhe nëse ato janë në përputhje me normat evropiane mjedisore;
- një plan rehabilitimi mjedisor, me masa konkrete, që do të realizohet pasi të demontohet burimi gjenerues, në mënyrë që të sigurohet një mbrojtje e kujdesshme e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë së njerëzve, përfshirë përmirësimin e mjedisit pas mbylljes së veprimtarisë;
- vlerësimin e ndikimit në mjedis të projektit të propozuar;
- karakteristika të veçanta, në lidhje me aftësitë teknike, ekonomike dhe financiare.

2. Kriteret, që duhet të plotësojë objekti që do të ndërtohet, janë:

- të garantojë se vënia në punë e këtij objekti nuk cenon sigurinë e sistemit tonë elektro-energjetik;
- të sigurojë se ndërtimi dhe shfrytëzimi i këtij objekti nuk ndikon në shëndetin dhe në jetën e publikut;
- të sigurojë se ndërtimi dhe shfrytëzimi i këtij objekti jep kontribut në reduktimin e emetimeve të gazrave të efektit serë dhe nuk ka ndikime të rëndësishme negative në mjedis;
- të garantojë një përdorim racional të tokës dhe kthimin e saj në gjendjen fillestare, pas përfundimit të veprimtarisë prodhuese të objektit;

- të sigurojë efikasitet të energjisë;
- të përdorë teknikat më të mira, të disponueshme, që sigurojnë mbrojtjen e mjedisit dhe minimizimin e ndotjes.

Neni 9

Të dhënat, informacionet dhe kriteret specifike, sipas tipit të burimit gjenerues të energjisë elektrike

(shfuqizuar dhe shtuar nënndarje në pikën DH me VKM nr. 117, datë 6.3.2024)

Një kërkesë paraqet në ministri, në varësi të tipit të burimit gjenerues të propozuar, përveç sigurisë për plotësimin e kriterëve të shprehura në pikën 2, të nenit 8, të këtyre rregullave, edhe të dhënat, informacionet dhe kriteret specifike të mëposhtme:

A. Për një termocentral (TEC):

- teknologjinë e përdorur në burimin gjenerues të energjisë (me cikël të thjeshtë, me cikël të kombinuar etj.) dhe parametrat teknikë të pajisjeve kryesore (kaldaja, turbina, motorë me djegie të brendshme, gjeneratorë, transformatorë);
- llojin e lëndës djegëse që përdor;
- efikasitetin termike, elektrike dhe totale të burimit gjenerues të energjisë;
- konsumin specifik të lëndës djegëse;
- fuqinë kalorifike të lëndës djegëse;
- burimet e furnizimit me lëndë djegëse;
- respektimin e normave mjedisore për shkarkimet në ajër, ujë dhe tokë, si dhe për çdo komponent mjedisor, sipas legjisllacioneve në fuqi në fushën e mjedisit.

B. Për një burim gjenerues të prodhimit të kombinuar të energjisë elektrike dhe nxehtësisë (me koogjenerim):

- teknologjinë e përdorur në burimin gjenerues të energjisë;
- llojin e lëndës djegëse;
- efikasitetin termike, elektrike dhe totale të burimit gjenerues të energjisë;
- konsumin specifik të lëndës djegëse;
- fuqinë kalorifike të lëndës djegëse;
- kapacitetin termik dhe elektrik të burimit gjenerues të energjisë;
- destinacionin e nxehtësisë së prodhuar;
- kapacitetin termik të kaldajës mbështetëse, nëse ka;
- respektimin e normave mjedisore për shkarkimet në ajër, ujë dhe tokë, si dhe për çdo komponent mjedisor, sipas legjisllacioneve në fuqi në fushën e mjedisit.

C. Për një gjenerues me erë:

- të dhëna për potencialin e erës në zonën e propozuar;
- shpejtësinë minimale dhe maksimale të shfrytëzueshme të erës;
- shpejtësinë mesatare vjetore të erës;
- tipin dhe lartësinë e kullës eolike;
- diametrin e rotorit të gjeneruesit;
- numrin e kullave, nëse do të jetë një park eolik;
- respektimin e normave mjedisore akustike dhe vizuale;
- respektimin e normave mjedisore për shkarkimet në ajër, ujë dhe tokë, si dhe për çdo komponent mjedisor, sipas legjisllacioneve në fuqi në fushën e mjedisit.

Ç. Për një sistem fotovoltaiik:

- karakteristikat teknike të sistemit fotovoltaiik;
- rrezatimin diellor mesatar vjetor, të vendit ku do të ndërtohet sistemi, $[kJ/m^2 \text{ në vit}]$;
- këndin optimal të përthyerjes, të panelit diellor;
- sipërfaqen, në metra katrorë, të panelit të instaluar;
- respektimin e normave mjedisore për shkarkimet në ajër, ujë dhe tokë, si dhe për çdo

komponent mjedisor, sipas legjislacioneve në fuqi në fushën e mjedisit.

D. Për një burim gjenerues me biomasë:

- teknologjinë e përdorur në burimin gjenerues të energjisë elektrike;
- llojin e biomasës;
- konsumin specifik të lëndës djegëse biomasë;
- fuqinë kalorifike të lëndës djegëse;
- mënyrën e sigurimit dhe furnizimit me biomasë;
- respektimin e normave mjedisore për shkarkimet në ajër, ujë dhe tokë, si dhe për çdo

komponent mjedisor, sipas legjislacioneve në fuqi në fushën e mjedisit.

DH. Për një vetëprodhues mbi 1 mw:

- teknologjinë e përdorur në burimin gjenerues të energjisë;
- shfuqizuar;
- shfuqizuar;
- shfuqizuar;
- sasinë e pritshme të energjisë elektrike, që do të konsumohet për nevojat e tij vetjake;
- sasinë e pritshme të energjisë elektrike, që do të absorbohet ose injektohet në rrjetin kombëtar;
- respektimin e normave mjedisore për shkarkimet në ajër, ujë dhe tokë, si dhe për çdo

komponent mjedisor, sipas legjislacioneve në fuqi në fushën e mjedisit.

- Deklarimin e pranimi të një pike lidhjeje në rrjet me një drejtim, e ndryshme nga pika e furnizimit dhe pranimi të përjashtimit nga skemat e mbështetjes për vetëprodhuesit.

Neni 10

Studimi i parafisibilitetit

(zëvendësuar fjalë në pikën 1 me VKM nr. 718, datë 12.10.2016; shtuar paragraf në fund të pikës 2 me VKM nr. 192, datë 5.4.2023; shtuar paragraf në pikën 2 me VKM nr. 117, datë 6.3.2024)

1. Kërkuesi, në përputhje me nenin 8, të këtij vendimi, paraqet një studim parafisibiliteti, që jep besueshmëri të mjaftueshme teknike, ekonomike dhe financiare të projektit të propozuar, si dhe ndikimin e tij mjedisor dhe social.

2. Studimi i parafisibilitetit, i paraqitur sipas pikës 1, të këtij neni, përfshin:

a) Në terma teknikë, studimi duhet të japë informacion lidhur me besueshmërinë teknike të projektit të propozuar dhe duhet të shoqërohet me paraqitjen e përgjithshme skematike të burimit gjenerues të energjisë; një diagram elektrik të aggregateve dhe bllokut të transformimit, ku të evidentohen qartë pika e lidhjes me sistemin dhe pika e matjes; opinionin paraprak të OST-së ose OSSH-së mbi lidhjen e tij me sistemin e transmetimit ose shpërndarjes së energjisë elektrike; shtrirjen gjeografike të vendit ku do të ngrihet apo zhvillohet veprimtaria, duke dhënë referencat ekzakte (numër parcele, numër regjistri kadastre) dhe të paraqitura në hartë, me shkallë 1:25 000; një hartë topografike, ku të paraqitet gjurma e linjës që lidh burimin gjenerues me sistemin e transmetimit ose shpërndarjes, në shkallë 1:25 000.

Për aplikimet për burime gjeneruese eolike, të zotërojnë të dhëna të matura të erës, të mbledhura nëpërmjet matjeve, për zonën e propozuar të zhvillimit të projektit.

Opinionin paraprak i OST-së ose OSSH-së në këtë fazë të procesit shërben vetëm për të përcaktuar mundësinë e lidhjes në rrjet. Ky opinion nuk angazhon OST-në ose OSSH-në për rezervimin e kapaciteteve të rrjetit, deri në pajisjen e subjekteve me miratim paraprak nga ministri sipas këtij vendimi.

b) Në terma ekonomike, studimi duhet të paraqesë një plan biznesi, që demonstroi besueshmërinë ekonomike të projektit të propozuar. Plani i biznesit duhet të përcaktojë, minimalisht, shpenzimet dhe të ardhurat e pritshme si dhe kohëzgjatjen e periudhës së ndërtimit, në muaj. Kostot duhet të ndahen në kategoritë përkatëse: kostot financiare, kostot e ndërtimit (përfshirë kostot lidhur me fuqinë punëtore, makineritë dhe lidhjen me rrjetin), kostot e operimit dhe të mirëmbajtjes.

c) Në terma financiarë, studimi duhet të paraqesë një plan financiar që demonstroi

besueshmërinë financiare të projektit të propozuar. Plani financiar duhet të përcaktojë, në mënyrë të qartë dhe transparente, se si synon kërkuesi të financojë projektin e propozuar. Ai duhet të përcaktojë, minimalisht, sasinë e alokuar të kapitalit të vet, ndaj burimeve financiare të jashtme të kërkuara, burimet konkrete të financimit nga jashtë dhe një program të detajuar financimi. Kërkuesi duhet të paraqesë dokumente, në formën e një letre interesi, marrëveshje paraprake kreditimi ose çdo dokument tjetër, që vërtetojnë mbështetjen financiare të projektit nga institucionet financiare ose bankat vendase apo të huaja, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë kërkuetit, kredi bankare, donacione apo financime të tjera).

c) Në terma të impaktit mjedisor dhe social, studimi duhet të japë një informacion të detajuar dhe të besueshëm lidhur me ndikimin mjedisor dhe social të projektit të propozuar. Kërkuesi duhet të sigurojë informacion lidhur me ndikimin pozitiv ose negativ të projektit mbi përdorimin e tokës, biodiversitetin dhe peizazhin, efektet lidhur me ndërtimin e burimit gjenerues të energjisë, emetimin e gazrave në atmosferë, tokë ose ujë, ndotjen akustike, si dhe çdo ndikim social të projektit, si p.sh. ato për punësimin lokal, përmirësimin e infrastrukturës ose çdo ndikim tjetër të rëndësishëm mjedisor ose social. Studimi mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis duhet të bazohet në legjislacionin në fuqi.

Neni 11

Kërkesa nga një bashkim shoqëror

(ndryshuar pika 2 dhe 3 me VKM nr. 718, datë 12.10.2016)

1. Kërkesa për ndërtimin e burimeve të reja gjeneruese të energjisë mund të bëhet edhe nga më shumë se një person, në formën e një bashkimi shoqëror.

2. Përpara dorëzimit të kërkesës, bashkimi i përkohshëm i shoqërive duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar dhe ku të përcaktohet përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së secilës shoqëri dhe detyrimet e përgjithshme që do të përmbushë secila nga shoqëritë e këtij bashkimi të përkohshëm. Vullneti për të hyrë në marrëveshje të bashkimit të përkohshëm të shoqërive duhet të jetë i shprehur qartë, me vendim të organit vendimmarrës të të gjitha shoqërive pjesëmarrëse, në kontratën e bashkimit të përkohshëm.

Pas krijimit të bashkimit të përkohshëm të shoqërive, anëtarët e këtij bashkimi caktojnë një përfaqësues, i cili është i autorizuar, nëpërmjet një prokure të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e bashkimit, për të vepruar në emër të tyre për qëllimin e kërkesës.

3. Dokumentet e përcaktuara në nenin 7, të këtyre rregullave, përveç shkronjës “e”, duhet të paraqiten nga secili anëtar i bashkimit të shoqërive.

Plotësimi i kriterëve ekonomike, financiare, profesionale dhe atyre teknike duhet të përmbushen nga i gjithë grupi, në përputhje me përcaktimet e aktmarrëveshjes së bashkimit të përkohshëm të shoqërive.

4. Ministria kërkon, në këtë rast, dokumentacionin e nevojshëm për përgjegjësinë solidare të bashkimit të përkohshëm të shoqërive, për realizimin e projektit.

Neni 12

Shqyrtimi i dokumenteve të kërkuetit

(ndryshuar pika 3 me VKM nr. 718, datë 12.10.2016)

1. Ministria shqyrton nëse dokumentet e depozituara nga kërkuesi janë në përputhje me kërkesat e këtyre rregullave.

2. Ministria mund të verifikojë besueshmërinë dhe saktësinë e të dhënave të dokumenteve.

3. Nëse dokumentet dhe informacioni i paraqitur nga kërkuesi janë të plotë dhe në përputhje me kërkesat e neneve 7, 8, 9 e 10, të këtyre rregullave, ministria i komunikon kërkuetit ose të deleguarit përgjegjës të tij pranimin e kërkesës, brenda 20 (njëzet) ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së kërkesës ose, për rastet kur për burimin/pellgun, kuotat e kërkuara ka informacion se nuk është i lirë dhe i mundshëm, nga data në të cilën është depozituar në ministri informacioni i institucionit

përkatës se burimi/pellgu, kuotat e kërkuara janë të lira dhe të mundshme.

Neni 13

Paraqitja e dokumentacionit të munguar

1. Në rastet kur në kërkesë mungon ndonjë nga dokumentet ose informacionet e parashikuara në nenet 7, 8, 9 e 10, të këtyre rregullave, Ministria i kërkon kërkuarit të paraqesë dokumentacionin e munguar, brenda 10 ditëve kalendarike nga dita e njoftimit për plotësimin e tij.

2. Nëse kërkuarisi nuk paraqet dokumentacionin e munguar brenda periudhës së specifikuar në pikën 1, të këtij neni, Ministria refuzon kërkesën dhe kthen mbrapsht dokumentacionin.

Neni 14

Mbivendosja e vendndodhjeve të kërkesave

(ndryshuar pika 2 me VKM nr. 718, datë 12.10.2016)

1. Në rast se për të njëjtën vendndodhje paraqiten dy ose me shumë kërkesa, Ministria merr në shqyrtim kërkesën e paraqitur të parin në kohë.

2. Nëse kërkesa i paraqitur i pari në kohë refuzohet, atëherë do të vijohet me shqyrtimin e kërkesës vijues, nëse ka, e kështu me radhë.

Neni 15

Publikimi i kërkesës

1. Kur kërkesa pranohet, Ministria publikon tri ditë me radhë, në faqen e *website*-it të ministrisë, një njoftim me përmbajtjen e mëposhtme:

- një prezantim të shkurtër të kërkuarit;
- një përshkrim të shkurtër të projektit të propozuar;
- informacionin se ku mund të gjendet nga publiku kërkesa e detajuar;
- adresën e Ministrisë, ku mund të dërgohen objeksionet ose komentet lidhur me kërkesën;
- afatin për dërgimin e objeksioneve ose komenteve në ministri.

2. Ministria siguron që kërkesa dhe të gjitha dokumentet shoqëruese, si dhe çdo informacion tjetër, të jenë të disponueshme për konsultim publik, në mjediset e saj.

3. Ministria, duke marrë në konsideratë kërkesën e kërkuarit, mund të vendosë se cilat dokumente ose të dhëna të veçanta do të mbahen konfidenciale dhe mund të ndalojë njohjen e tyre nga publiku.

Neni 16

Objeksionet

1. Çdo person, që ka një interes ligjor, mund të paraqesë, brenda 15 ditëve nga data e publikimit, sipas pikës 1, të nenit 15, të këtyre rregullave, në Ministri, objeksionet e tij lidhur me një kërkesë të bërë.

2. Ministria informon kërkuarin për objeksionet që mund të ketë marrë, lidhur me kërkesën e tij, dhe kërkon sqarime nga kërkuarisi për objeksionet e bëra, brenda 15 ditëve kalendarike.

3. Ministria nuk merr në konsideratë asnjë objeksion, nëse është bërë më vonë se afati i përcaktuar në pikën 1, të këtij neni.

Neni 17

Komisioni i vlerësimit të kërkesës

1. Kërkesa merret në shqyrtim dhe fillon të vlerësohet vetëm pas kalimit të afatit të përcaktuar në nenin 16, të këtyre rregullave, për paraqitjen e objeksioneve.

2. Ministri, për vlerësimin e një projekti të propozuar, krijon një komision vlerësimi me specialistë

për ekspertizën e nevojshme teknike, ekonomike dhe juridike, të përbërë prej 7 anëtarësh. Kryetar i komisionit caktohet njëri prej drejtuesve të lartë të ministrisë.

3. Nëse, për vlerësimin e një propozimi, kërkohet ekspertizë e veçantë, mund të caktohen anëtarë të komisionit të vlerësimit të kërkesës edhe specialistë nga institucione të tjera.

4. Komisioni, në procesin e vlerësimit të një kërkesë, nëse e konsideron të nevojshme, mund të kërkojë ekspertizë dhe konsultë të huaj, shpenzimet e të cilave do të përballohen nga kërkuesi.

5. Ministri nxjerr një urdhër për krijimin dhe funksionimin e komisionit të vlerësimit të kërkesës.

Neni 18

Vlerësimi i kërkesës

Komisioni i vlerësimit të kërkesës merr në shqyrtim kërkesën, lidhur me:

- a) aftësitë teknike, ekonomike dhe financiare të kërkuetit;
- b) sigurimin e stafit të aftë dhe kompetent;
- c) strategjinë kombëtare të energjisë, të miratuar nga Këshilli i Ministrave, ose ndonjë dokument tjetër të politikave energjetike për ndërtimin e burimeve të reja gjeneruese të energjisë;
- ç) rendimentin e burimit gjenerues të energjisë;
- d) plotësimin e kushteve dhe standardeve mjedisore, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) vendndodhjen gjeografike të burimit gjenerues të energjisë, përkundrejt sistemit të përgjithshëm kombëtar të prodhimit dhe furnizimit me energji;
- e) interferimin e burimit të ri gjenerues me shfrytëzimin e burimeve gjeneruese ekzistuese ose të atyre burimeve gjeneruese që janë autorizuar ose që janë në procesin e ndërtimit;
- ë) nëse karakteristikat e burimit të ri gjenerues të energjisë sigurojnë koordinim të përshtatshëm me sistemin elektroenergetik;
- f) zgjidhjen teknike të lidhjes së burimit gjenerues të energjisë me rrjetet e transmetimit ose shpërndarjes;
- g) objeksionet e paraqitura lidhur me kërkesën, sipas nenit 16, të këtyre rregullave;
- gj) sasinë e energjisë elektrike, (por jo më të vogël se 2% të sasisë vjetore të prodhimit ose konvertimin e saj në vlerë), që do të jepet falas, në formë *myalhy*, ministrisë. Në rast konvertimi në vlerë monetare, këto të ardhura derdhen tërësisht në buxhetin e shtetit.

Neni 19

Miratimi paraprak për vazhdimin e procedurave

(ndryshuar shkronja "c" e pikës 3 me VKM nr. 192, datë 5.4.2023)

1. Komisioni i vlerësimit të kërkesës i paraqet ministrit, brenda 45 ditëve nga marrja e kërkesës, sipas pikës 1, të nenit 17, të këtyre rregullave, një raport lidhur me miratimin ose refuzimin e kërkesës.

2. Ministri, në rast të një raporti pozitiv të komisionit të vlerësimit të kërkesës, i lëshon kërkuetit një miratim paraprak për vazhdimin e procedurave për marrjen e të drejtës së ndërtimit.

3. Miratimi paraprak për vazhdimin e procedurave përmban:

- a) emrin e kërkuetit;
- b) të drejtën ekskluzive të kërkuetit për të bërë matje ose studime të tjera, lidhur me investimet për ndërtimin e burimit gjenerues të energjisë;
- c) afatin maksimal 6-mujor (gjashtëmujor), brenda të cilit kërkuesi duhet të përfundojë matjet ose studimet e tjera lidhur me investimin, sipas shkronjës "b", të kësaj pike, si dhe dokumentacionin e përcaktuar në nenin 20, të këtij vendimi.

4. Ministri, në rast të një vendimi negativ, njofton kërkuetit për refuzimin e kërkesës, duke dhënë argumentimin përkatës për arsyet e këtij vendimi.

5. Kërkuesi, të cilit i është refuzuar kërkesa, ka të drejtë të ankohet në Gjykatën Administrative, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 20

Paraqitja e dokumenteve të tjera

(ndryshuar fjalë në shkronjën “dh” me VKM nr. 718, datë 12.10.2016; shfuqizuar shkronja “dh” me VKM nr. 192, datë 5.4.2023; shtuar shkronja “e” me VKM nr. 117, datë 6.3.2024)

Kërkuesi, i pajisur me miratimin paraparak, sipas pikës 2, të nenit 19, të këtyre rregullave, i paraqet Ministrisë, brenda periudhës kohore të përcaktuar në miratimin paraparak, me qëllim marrjen e miratimit përfundimtar, sipas shkronjës “c”, të pikës 3, të nenit 19, të këtyre rregullave, dokumentet e mëposhtme:

- a) studimin e plotë të fisibilitetit teknik, ekonomik, financiar, mjedisor e social, bazuar në të dhëna dhe matje reale, të kryera në zonat e zbatimit të projektit;
- b) planin e biznesit të projektit;
- c) grafikun e zbatimit të projektit;
- ç) miratimin e OST-së ose OSSH-së për pikën e lidhjes me rrjetin e transmetimit ose të shpërndarjes, sipas kërkesave të kodit të transmetimit ose shpërndarjes;
- d) lejet, licencat dhe autorizimet paraprahe mjedisore, nga institucionet përgjegjëse kombëtare;
- dh) shfuqizuar.
- e) oponencën teknike për projektpropozimin nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN).

Neni 21

Dhënia e miratimit për ndërtim

1. Komisioni shqyrton, brenda 20 ditëve kalendarike, nga dita e paraqitjes, plotësinë dhe saktësinë e të gjitha dokumenteve të paraqitura nga kërkuesi, sipas nenit 20, të këtyre rregullave.

2. Ministri, nëse arrin në përfundimin se të gjitha dokumentet e paraqitura nga kërkuesi, sipas nenit 20, të këtyre rregullave, janë të plota dhe të sakta, i dërgon Këshillit të Ministrave propozimin për miratimin e ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese mbi 2 mw, të cilat nuk janë objekt koncesioni.

Neni 22

Përmbajtja e miratimit të ndërtimit

(shfuqizuar shkronja “d”, ndryshuar shkronja “dh” dhe “j” me VKM nr. 718, datë 12.10.2016; ndryshuar shkronja “dh” me VKM nr. 117, datë 6.3.2024)

Miratimi për ndërtim kapacitetesh të reja prodhuese, i Këshillit të Ministrave, sipas nenit 21, të këtyre rregullave, përfshin elementet e mëposhtme:

- a) emrin dhe selinë e mbajtësit të miratimit;
- b) të drejtën e dhënë nga miratimi (tipin, kapacitetin dhe teknologjinë e burimit gjenerues të energjisë);
- c) vendndodhjen e burimit gjenerues të energjisë;
- ç) afatin e miratimit të ndërtimit;
- d) shfuqizuar;
- dh) të drejtën për të monitoruar, mbikëqyrur, testuar dhe certifikuar impiantin dhe veprimtarinë e Mbajtësit të Miratimit nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore nën mbikëqyrjen e ministrisë përgjegjëse për energjinë;
- e) detyrimin që mbajtësi i miratimit të paraqesë periodikisht (çdo tre muaj) pranë Ministrisë, informacion mbi ecurinë e ndërtimit të burimit gjenerues të energjisë;
- ë) çdo kufizim, lidhur me mbrojtjen e natyrës;
- f) detyrimin e dorëzimit prej kërkuesit të sigurimit të kontratës, në masën jo më pak 5% të vlerës së investimit, përpara nënshkrimit të kontratës ndërmjet kërkuesit dhe ministrisë. Në këtë kontratë përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve për realizimin e këtij projekti, penalitetet, në rast

mosrealizimi, si dhe çështje të tjera, që lidhen me zbatimin e saj;

g) detyrimin e mbajtësit të miratimit, për pagesën e *royalty*, të shprehur nga aplikanti, sipas shkronjës “gj”, të nenit 18, të këtyre rregullave;

gj) kërkesën, sipas rastit, që një pjesë e prodhimit të burimit gjenerues të energjisë t’i shitet furnizuesit publik, sipas legjislacionit në fuqi.

KAPITULLI III

NDËRTIMI I BURIMEVE GJENERUESE DERI NË 2 MW

(ndryshuar titulli me VKM nr. 718, datë 12.10.2016)

Neni 23

Ndërtimi i objekteve gjeneruese me kapacitet prodhues deri në 2 mw

(ndryshuar titulli me VKM nr. 718, datë 12.10.2016)

Ndërtimi i objekteve të reja, si dhe i atyre gjeneruese ekzistuese, që nuk janë objekt koncesioni, me kapacitet deri në 2 mw fuqi e instaluar, bëhet me miratim të ministrit. Për dhënien e miratimit zbatohen procedurat e parashikuara në nenet 4 deri 22, të këtyre rregullave.

Neni 24

Të dhënat, informacionet dhe kriteret specifike për ndërtimin e hidrocentraleve

(ndryshuar shkronja “c” e pikës 1 dhe shkronjat “a”, “b”, “e”, “f”, “g” të pikës 2 me VKM nr. 718, datë 12.10.2016)

1. Në momentin e kërkesës për ndërtimin e një hidrocentrali, kërkuksi paraqet në Ministri, përveç sigurisë për plotësimin e kriterëve, të shprehura në pikën 2, të nenit 8, të këtyre rregullave, edhe të dhënat, informacionet dhe kriteret specifike të mëposhtme:

a) zgjidhjen teknike, për një shfrytëzim maksimal të potencialit ujor, ku të përcaktohet fuqia e instaluar e projektuar e centralit dhe energjia mesatare vjetore që mendohet të prodhohet;

b) mënyrën e operimit të HEC-it;

c) opinionin e marrë nga organet e përcaktuara në aktet ligjore apo nënligjore, për prioritetin dhe për sasinë e ujit që mund të përdoret për prodhimin e energjisë elektrike;

2. Pas marrjes së miratimit paraprak, sipas procedurave të parashikuara në nenet 10-19, kërkuksi i paraqet ministrit, brenda periudhës kohore të përcaktuar në miratimin paraprak, me qëllim marrjen e miratimit përfundimtar, sipas shkronjës “c”, të pikës 3, të nenit 19, të këtyre rregullave, dokumentet e mëposhtme:

a) studimin e plotë të fisibilitetit teknik, mjedisor e social, si dhe projektin e zbatimit, të bazuar në të dhëna dhe matje reale, të kryera në zonat e zbatimit të projektit;

b) studimin e plotë ekonomik dhe financiar të projektit, të shoqëruar me dokumente që vërtetojnë financimin nga vetë kërkuksi, apo/dhe mbështetjen financiare të projektit nga institucionet financiare ose bankat vendase apo të huaja, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit;

c) grafikun e zbatimit të projektit;

ç) miratimin e OST-së ose OSSH-së për pikën e lidhjes me rrjetin e transmetimit ose të shpërndarjes, sipas kërkesave të kodit të transmetimit ose shpërndarjes;

d) lejet, licencat dhe autorizimet paraprake mjedisore, nga institucionet përgjegjëse kombëtare;

dh) studimin gjeologjik;

e) studimin hidrogeologjik;

ë) oponencën për projektin e zbatimit nga ana e AKBN-së. Në rastin e projekteve të paraqitura nga kërkuksi, për të cilat është kryer më parë oponenca nga ana e AKBN-së, kërkuksi mund ta paraqesë atë projekt në ministri, të rikonfirmuar nga AKBN-ja, pa qenë e nevojshme ta kalojë përsëri për oponencë pranë saj;

f) miratimin për përdorimin e ujit, të lëshuar nga organet përkatëse të përcaktuara në aktet ligjore apo nënligjore;

g) dokumentacionin ligjor, në përputhje me dispozitat e Kodit Civil, që provon marrëdhënien afatgjatë mbi pasurinë që do të përdoret për ndërtimin dhe operimin e burimit gjenerues. Në rastin kur pasuria është pronë shtetërore, ministria, me kërkesë të kërkuarit, mund të ndihmojë këtë të fundit për zgjidhjen e marrëdhënies së pronësisë me institucionet përkatëse, që kanë në administrim/pronësi pasurinë, pronë shtetërore.

Neni 25

Dhënia e miratimit për ndërtim për objektet deri në 2 mw *(ndryshuar pika 1 me VKM nr. 718, datë 12.10.2016)*

1. Ministri, nëse arrin në përfundimin se të gjitha dokumentet e paraqitura nga kërkuari, sipas këtyre rregullave, janë të plota e të sakta, miraton ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese deri në 2 mw apo zgjerimin e kapaciteteve, për objektet që nuk janë objekt koncesioni. Në çdo rast, ministri mund të miratojë vetëm zgjerim të kapaciteteve që nuk tejkalojnë 2 mw.

2. Miratimi i ministrit përmban elementet e përcaktuara në nenin 22, të këtyre rregullave.

KAPITULLI IV

TË DREJTA DHE DETYRIME PËR MBAJTËSIN E TË DREJTËS SË NDËRTIMIT

Neni 26

Detyrimi për dhënien e informacionit

1. Mbjtësi i miratimit i dërgon ministrisë, çdo 3 (tre) muaj, nga data e miratimit të ndërtimit, një raport mbi veprimtaritë e tij për ndërtimin e burimit gjenerues të energjisë.

2. Ministria, pa u kufizuar nga pika 1, e këtij neni, ka të drejtë t'i kërkojë subjektit çdo informacion që e konsideron të nevojshëm, lidhur me zbatimin e miratimit të ndërtimit.

Neni 27

Zgjatja e afatit të miratimit të ndërtimit

1. Mbjtësi i miratimit të ndërtimit mund t'i paraqesë ministrisë një kërkesë me shkrim për zgjatjen e afatit të ndërtimit, duke dhënë arsyet për zgjatjen e kërkuar.

2. Ministria, nëse e gjen të argumentuar, sipas rastit, miraton zgjatjen e ndërtimit ose, në rast të objekteve mbi 2 mw, vijon procedurat për propozimin e ndryshimit në Këshillin e Ministrave.

3. Në rast se Ministria nuk e gjen të argumentuar zgjatjen e afatit të ndërtimit, revokon të drejtën e ndërtimit ose i propozon Këshillit të Ministrave shfuqizimin e të drejtës së ndërtimit.

4. Çdo zgjatje e afatit të së drejtës së miratimit për ndërtimin e një burimi gjenerues të energjisë, siç përcaktohet në pikën 1, të këtij neni, mund të jepet vetëm një herë dhe mund të jetë jo më e gjatë se gjysma e periudhës së ndërtimit.

Neni 28

Transferimi i së drejtës për ndërtim

1. E drejta për ndërtimin e një burimi gjenerues të energjisë, e dhënë sipas këtyre rregullave, mund të transferohet te një person i tretë, tërësisht ose pjesërisht, vetëm me miratimin e ministrit ose të Këshillit të Ministrave, sipas rastit të miratimit fillestar. Çdo transferim te të tretët, pa miratimin e ministrit apo të Këshillit të Ministrave, është i pavlefshëm.

2. Transferimi i të drejtës së ndërtimit nuk prish cilësinë dhe nuk përkeqëson vazhdimësinë e realizimit dhe të përmbushjes së detyrimeve.

3. Subjekti që pajiset me të drejtën e ndërtimit duhet të plotësojë dhe të dorëzojë pranë ministrisë të gjithë dokumentacionin e përcaktuar në nenin 7, të këtyre rregullave.

Neni 29
Heqja e miratimit

1. Ministri ose Këshilli i Ministrave, në varësi të kapacitetit të instaluar, mund të vendosë për heqjen e miratimit të ndërtimit, në rastet e mëposhtme:

- me kërkesë me shkrim të mbajtësit të së drejtës, në raste të veçanta, të justifikuara;
- në rast se subjekti nuk ka plotësuar detyrimet dhe kriteret e përcaktuara në aktin e miratimit;
- nëse nuk është zbatuar grafiku i punimeve dhe nëse brenda 30 ditëve, nga njoftimi që Ministria i bën aplikantit, ky i fundit nuk justifikon mos-realizimin e detyrës dhe nuk dokumenton mundësitë e tij për të përfunduar, në datën e përcaktuar, objektin ose ndonjë fazë të tij;
- nëse mbajtësi i tij nuk informon, siç kërkohet nga neni 26, i këtyre rregullave, dhe nëse brenda një afati prej 15 ditësh, pas njoftimit paraprak nga ministria, kërkuksi përsëri nuk dërgon informacionin e kërkuar;
- nëse vërtetohet se deklaratimet e subjektit nuk janë të vërteta;
- kur, për mbajtësin e të drejtës së ndërtimit, kanë filluar procedurat e falimentimit ose likuidimit, sipas legjislacionit në fuqi;
- kur mbajtësi i të drejtës së ndërtimit nuk plotëson detyrimin e përcaktuar në shkronjën “gj”, të nenin 18.

2. Në çdo rast, heqja e të drejtës së ndërtimit argumentohet dhe i njoftohet subjektit.

KAPITULLI V
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 30
Kopjet e miratimit

1. Një miratim për ndërtim burimi gjenerues të energjisë elektrike, me kapacitetet mbi 2 mw, lëshohet në tri kopje, prej të cilave një kopje i bashkëngjitet dosjes së mbajtur në arkivin e Këshillit të Ministrave, një kopje e mban ministria dhe një kopje i jepet kërkuksit.

2. E drejta e ndërtimit për kapacitetet deri në 2 mw lëshohet në dy kopje, një prej të cilave i bashkëngjitet dosjes së mbajtur në arkivin e ministrisë dhe një kopje i jepet kërkuksit.

Neni 31
Dispozita kalimtare
(shtuar një fjali me vendimin nr. 633, datë 27.10.2021)

Çdo kërkesë e bërë në ministri, për ndërtimin e burimeve të reja gjeneruese të energjisë, që nuk janë objekt koncesioni, mbi ose deri në 2 mw, pas miratimit të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, trajtohet sipas dispozitave të këtyre rregullave. Në rastin e kapaciteteve prodhuese të energjisë nga hidrocentralet, ky vendim zbatohet vetëm për subjektet që janë pajisur me ‘Miratim paraprak të ndërtimit të kapaciteteve të reja të energjisë’, përpara se të hynte në fuqi ligji nr. 61/2020, ‘Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 43/2015, ‘Për sektorin e energjisë elektrike’, të ndryshuar’.

ANEKSI 1
FORMAT KËRKESE PËR NDËRTIMIN E NJË CENTRALI ELEKTRIK

Ministria e Energjisë dhe Industrisë
Sheshi “Skënderbej”, nr. 2,
Tiranë
Shqipëri

P.O. Box (kutia postare) 1001

Unë i nënshkruari, administrator i shoqërisë, përfaqësuar nga i deleguari im përgjegjës, në përputhje me ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe vendimit të nr....., datë..... “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike që nuk janë objekt koncesioni” aplikoj për ndërtimin e centralit elektrike

Kërkesa shoqërohet nga dokumentet e mëposhtme:

- 1.....
- 2.....
- 3.....
- 4.....
- 5.....
- 6.....
- 7.....
- 8.....
- 9.....
- 10.....
- 11.....
- 12.....
- 13.....
14.
15.

Administratori,
[Emër, mbiemër] [vula]

I. TË DHËNA PËR KËRKUESIN

1. Emri i plotë i kërkuarit
2. Adresa ose selia e kërkuarit
3. Numri i telefonit të kërkuarit
4. Numri i faksit të kërkuarit
5. I deleguari përgjegjës i kërkuarit (nëse ka)
Emri
Nr. i telefonit
Nr. i faksit
6. Forma ligjore e kërkuarit

II. TË DHËNA PËR CENTRALIN

1. Emri i centralit
2. Vendndodhja e centralit
3. Tipi i centralit elektrik (termo, hidro, ere, fotovoltaike, biomas ose tjetër)
4. Data e pritshme e futjes në punë të centralit të propozuar
5. Kapaciteti i instaluar i plotë i centralit dhe për çdo njësi gjeneruese (mw)
6. Jetëgjatësia e pritshme e centralit

III. INFORMACION SHITESË

Ju lutem jepni çdo informacion tjetër të rëndësishëm që kërkuari dëshiron të përfshijë në këtë kërkesë.

ANEKSI 2

VLERAT E PAGESAVE PËR KËRKESAT PËR MARRJEN E MIRATIMEVE PËR NDËRTIMIN E NJË CENTRALI ELEKTRIK

	Kapaciteti i centralit	Vlera (në lekë)
1.	Deri në 2 mw	100 000
2.	2 mw – 10 mw	150.000
3.	10 mw - 100 mw	200 000
4.	Më i madh se 100 mw	300 000

Pagesat do të bëhen në numrin e llogarisë të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë_____